



CARPO Police

Kurs për trajnim trajnerësh

"Hetimi financiar dhe konfiskimi I produkteve të krimt"

Përshkrimi i kursit & Axhenda (draft)

Një pasqyrë e përgjithshme:

Qëllimi madhor i projektit CARPO është të forcojë kapacitetet për kryerjen e hetimit financiar që kanë si qëllim konfiskimin e produkteve të krimt në Evropën Juglindore.

Pas hartimit dhe mbështetjes së një strategjie në fushën e zbatimit të hetimeve financiare, projekti ka hyrë në fazën e përgatitjes së një manuali trajnimi që do të shërbejë për trajnime të mëtejshme mbi këtë temë, në të 7 zonat e projektit.

Kursi për trajnim trajnerësh, (ToT), i organizuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg, zhvillohet me qëllim që t'i ndihmojë pjesëmarrësit të përvetësojnë njohuri trajnimi bazë, aftësi dhe zotësi që do t'u mundësojnë atyre më vonë të trajnojnë kolegët e tyre në fushën e hetimit financiar që ka si qëllim konfiskimin e produkteve të krimt.

Kursi katër-ditor është ndërtuar në mënyrë të tillë që të shfrytëzojë në maksimum, kohën që pjesëmarrësit e kalojnë në klasë. Metodologjia e përdorur do të lehtësojë përvetësimin e zotësive dhe të aftësive me anë të aktiviteteve praktike dhe diskutimeve inter-aktive. Pjesëmarrësve u kërkohet që të përgatiten para se të marrin pjesë në këtë kurs në Strasburg, duke lexuar materialet e trajnimit dhe duke përgatitur sesione trajnuese.

Pjesëmarrësit do të furnizohen me materiale bazë, që do t'u japin mundësinë atyre të zhvillojnë sesione trajnuese. Temat të përzgjidhen nga Manuali me temë: "Hetimi Financiar që synon Konfiskimin e Produkteve të Krimt".

Aspektet njohëse të këtij kursi kërkojnë leximin e detyrueshëm të këtyre materialeve, që do t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuritë dhe instrumentet e duhura, që do të shërbejnë si ndihmesë në përgatitjen e sesioneve trajnuese individuale që do të zhvillohen gjatë kursit.

Akoma më tej, leximi paraprakisht i këtyre materialeve do të mundësojë thellimin e njohurive dhe kuptimin më të mire, të temave të përzgjedhura si dhe përvetësimin apo perfeksionimin e aftësive dhe zotësive gjatë kursit.

Materiale të tjera mbi zhvillimin e trajnimit do të shpërndahen gjatë kursit, sipas nevojës.

Objektivat e kursit:

Në përfundim të kursit, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

1. Të zhvillojnë një seance trajnimi prej 20 minutash mbi disa tema të paracaktuara.
2. Të komentojnë sesionet e trajnimit të zhvilluara nga kolegët e tjerë, duke përdorur Ciklin e Mësimit me anë të Eksperiencës – Modelin e Raportimit (Experiential Learning Cycle – Debriefing Model)
3. Të kuptojnë ndryshimin ndërmjet metodave të trajnimit “që vënë në qendër studentin” dhe “që vënë në qendër (qendërsojnë) trajnerin” në kontekstin e mësimit të të rriturve.
4. Të rreshtojnë dhe të debatojnë lidhur me faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e metodave të trajnimit.

Dinamika e kursit:

E Hënë:

- Hapja e trajnimit, përmbledhja e programit, prezantimet, pritshmëritë e grupit, (hapja do të bëhet me të gjithë pjesëmarrësit, përpara se ata të ndahen në dy grupe).

- Pjesëmarrësit do të nisin të zhvillojnë një séance trajnimi. Ajo duhet të zgjasë 20 min mbi tema të paracaktura (të parazgjedhura), ose mbi pjesë të manualit.

- Pjesëmarrësit do të presin komentet e pjesës tjetër të grupit

-Ky proces do të koordinohet nga asistenti duke përdorur Debriefing Model of the Experiential Learning (Modelin Raportues të të Mësuarit me anë të Experiences) (David Kolb).

- Aty ku shihet e nevojshme, asistenti do të debatojë më grupin, mbi njohuritë, zotësitë dhe aftësitë që mund të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të kursit.

E Martë:

- përfundimi i sesioneve individuale të trajnimit dhe i raportimeve

- Aty ku shihet e nevojshme, asistenti do të debatojë më grupin, mbi njohuritë, zotësitë dhe aftësitë që mund të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të kursit.

E Mërkurë:

- Asistenti i kursit duke u “mbështetur” në vëzhgimet e ditëve të mëparshme do t’i ndihmojë pjesëmarrësit për të: kuptuar Ciklin e të Mësuarit me anë të Eksperiencës – Modelin Raportues; për të kuptuar dallimet ndërmjet metodave të trajnimit që “qendërsojnë trajnerin”

dhe atyre që “vënë në qendër studentin” në kontekstin e mësimit të të rriturve; të rreshtojnë dhe debatojnë mbi faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e metodave të trajnimit.

E Enjte:

– Aktivitete individuale, ku secili nga pjesëmarrësit do t’ia kushtojë një pjesë të kohës së tij reflektive mbi sesionet e trajnimit që ai/ajo do të zhvillojë pas kursit. “Plani i Veprimt” duhet të përfundohet dhe të diskutohet në grup.

- Asistenti do ta udhëheqë grupin dhe do të sqarojë kuptimet dhe metodologjinë.

- Nëse ende nuk është arritur të kryhet, para se të fillojë ky aktivitet, organizatori i kursit, duhet t’u shpejtojë pjesëmarrësve, se çfarë pritet prej tyre pas përfundimit të kursit.

- Mbyllja e kursit dhe vlerësimi.

Orari

Shënim i rendësishëm: për shkak të dinamikës së kursit, në axhendë është shënuar vetëm ora e fillimit të kursit (ora 09.00). Do të pasojnë dy pushime - një paradite dhe një pasdite, por ato duhet të jenë fleksibël, deri në përfundim të ditës (ora 17.00)

Pushimi për drekën do të jetë nga ora 13.00 deri në orën 14.00

E Hënë (Dita 1)

Ora	Përmbajtja	Aktiviteti/ Vërejtje
09.00-10.00	Mirëseardhja nga organizatorët. Prezantimi i pjesëmarrësve dhe i asistentëve; Pritshmëritë e grupit & përshkrimi i kursit	PLENARE “aktivitetet për shkrimin e akujve
	Të sqarohet kuptimi i Ciklit të Mësimit më anë të Eksperiencës & Raportimit (ELC	Kontrolli i njohurive & sqarimi i kuptimeve (termave)
	Sesioni i trajnimeve nga pjesëmarrësit (20 min) që do të pasohet nga raportimet e grupit dhe të asistentit.	Cikli i Mësimit me anë të Eksperiencës & Raportimi
Gjatë gjithë kohës	asistenti do të debatojë më grupin, mbi njohuritë, zotësitë dhe aftësitë që mund të kontribuojnë në arritjen e qëllimit dhe objektivave të kursit.	Si të shihet e nevojshme
13.00 - 14.00	Pushimi për drekën	

17.00	Mbyllja e aktiviteteve të ditës	
-------	---------------------------------	--

E Martë (Dita 2)

Ora	Përmbajtja	Aktiviteti/ Vërejtje
09.00-	Përmbledhja e ditëve të mëparshme & shqetësime e grupit	
	Vazhdimi i sesionit të trajnimeve të paraqitura nga pjesëmarrësit (20 min) që do të ndiqet nga raportimi	Cikli i Mësimit me anë të Eksperiencës & Raportimi
Gjatë gjithë kohës	Asistenti do të debatojë më grupin, mbi njohuritë, zotësitë dhe aftësitë që mund të kontribuojnë në arritjen e qëllimit dhe objektivave të kursit.	Sipas nevojës
13.00 - 14.00	Pushimi i drekës	
17.00	Mbyllja e aktiviteteve të ditës	

E Mërkurë (Dita 3)

Ora	Përmbajtja	Aktiviteti/ Vërejtje
09.00-	Përmbledhja e ditëve të mëparshme & shqetësimet e grupit	
	Cikli i Mësimit me anë të Eksperiencës & Modeli i Raportimit (Procesverbalit)	Diskutime nga grupi
	Vënia në Qendër e Trajnerit kundrejt Vënies në Qendër të Studentit Metodat e trajnimit të të rriturve (në moshë madhore)	Debate Aktivitete individuale
	Faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e metodave të trajnimit Nëse koha e lejon, debat mbi Predispozitat (Prirjet) dhe Taksonominë e Objektivave të	Ushtrim për “hartën e mendjeve” që ndiqet nga diskutimet e grupit

	Mësimi (D. Bloom)	
13.00 - 14.00	Pushimi i drekës	
17.00	Mbyllja e aktiviteve të ditës	

E Enjte (Dita 4)

Ora	Përmbajtja	Aktiviteti/ Vërejtje
09.00-	Përmbledhja e ditëve të shkuara & shqetësimet e grupit	
	Organizatorët e kursit duhet t'u flasin pjesëmarrësve mbi atë që pritet prej tyre në të ardhmen, në rast se është e nevojshme.	
	Çdo pjesëmarrës do të reflektojë mbi trajnimet në të ardhmen që ai/ajo do të zhvillojë pas përfundimit të kursit. Plani i Veprimit do të përfundohet dhe do të diskutohet me grupin. Asistenti do ta udhëzojë grupin dhe do të sqarojë keqkuptimet e mundshme.	Aktivitet individual
	Mbyllja & dhe dhënia energji grupit	“Pema prej Xhelatine”
13.00 - 14.00	Pushimi i drekës	
14.00 - 16.00	Raportimi / Vlerësimi i kursit Finalizimi i planeve të trajnimit / Aktivitetet e ardhshme Ceremonia e mbylljes (Certifikatat)	PLENARE